



Prishtinë, 13.04. 2017
Kodi i ZRRE: V_908_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Vendimi i ZRRE-së nr. V_517_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin e KEDS-OSSH-së për të hyrat e Lejuara në kuadër të Shqyrtimit Njëmbëdhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE11), të dorëzuar me datën 23 janar 2017,

në seancën e mbajtur më 31 mars 2017 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i **Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)** përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për vitin relevant tarifor SHTE11 duke filluar nga data 1 prill 2017.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OSSH-ja për vitin relevant tarifor SHTE11 janë përcaktuar në shumën **67,533,911** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për Të Hyrat e OSSH-së.
- IV. Mbajtësi i licencës për OSSH duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së tarifat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes të përcaktuar me MAR-in e këtij vendimi para vitit relevant tarifor.
- V. Tarifat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të aprovuar nga ZRRE.





AR SYE TIM

- ✚ Rregullatori më datë 23 janar 2017 ka pranuar nga KEDS aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale, që duhet mbledhur përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes(DUOS).
- ✚ Rregullatori për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale ka marrë parasysht dokumentet nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj:
 - Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe të Furnizuesit Publik , i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OSSH-së, i publikuar më datën 28 Shkurt 2017;
 - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH, i publikuar më datën 31 mars 2017;
- VI. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i shpërndarjes duke filluar nga 1 prilli 2017 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Krenar Bujupi, u.d kryesues


Arsim Janova, anëtar,


Besim Sejfiqaj, anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.